



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË
Komiteti për Politikë dhe Financa
I.Numër: 016/01-25906
Pejë, datë: 18 Mars 2022



PROCESVERBAL

Nga takimi i III-të i Komitetit për Politikë dhe Financa i KK Pejë, mbajtur me 18 mars 2022, në ora 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, z. Arianit Krasniqi Drejtor i çeshtjeve pronësore – juridike, z. Pandeli Rugova Shef i Zyrës Ligjore, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorin të Kuvendit, z. Egzon Kastrat Asistent Administrativ i Kryesuesit, dhe përfaqësuesit e ZIP.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se jemi të gjithë anëtarët prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës, ku i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendos në rend dite.

Unanimisht nga të gjithë prezent u miratu ky:

Rendi i Ditës

- 1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**
- 2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 18. Shkurt 2022.**
- 3. Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK:**

3.1. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës për këmbim prone në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit dhe Albert Ajdaj, nga Peja, për rregullim dhe zgjerim të shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU-së "Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci" Pejë.

3.2. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-ke dhe kryetarit të Komunës për këmbim të pronave në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Jakup Krasniqi, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e hapsirës gjelbëruese të shkollës fillore "7 Shtatori" në f.Vitomeriçë Komuna e Pejës.

3.3. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-ke dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Rahmon (Rexhë) Shala, nga Peja për rregullim e rrugës në Pejë, sipas PRRU-së.

3.4. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Mediha Hoxha, nga Peja, për rregullim e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU.

3.5. Shqyrtimi i kërkesë së "Let's Do It Peja", për angazhimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal Pejë, në Grupin punues për hartimin e "Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit" në Komunën e Pejës.

3.6. Rritja dhe bartja Buxhetore e mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake.

3.7. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe Plani për ndarjen e tyre për vitin 2022.

- 4. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.**

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk patë.

II. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 18 shkurt 2022.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua procesverbali i takimit të Komitetit për Politikë dhe Financa i dates: 18 shkurt 2022.

III

Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK-së:

3.1. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe Kryetarit të Komunës për këmbim prone në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit dhe Albert Ajdaj nga Peja, për rregullim dhe zgjerim të shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU-së “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj : kryetari në një seancë e ka përmendur listen e pronave që kanë me u kemby.

Z.Arianit Krasniqi : këtu bëhet fjalë për një këmbim të një parcele 90 metra katror që është pronë komunale , me parcelat e pronarit privat Albert Ajdaj me sipërfaqe 94 metra katror dhe një pjesë tjetër prej 122 metra katror, materialin ua kemi derguar paraprkisht, Drejtori Krasniqi e shpjegoj në mënyrë të detajuar përmes ortofotove pronën që po këmbehet me personin në fjalë ku shpjegoj që kjo pronë ndodhet te soliteri dhe është pronë komunale që pronari e shfrytëzon për hyrje te shtëpia, ndërsa prona e pronarit privat është me listen e pronave me interes të përgjithshëm të komunës dhe është pronë që sherben për rregullim dhe zgjerim të shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë .

Z. Berat Ganiqi : theksoi që materialin e kemi marrë, por pse janë vendosur aty ortofotot e vjetra kjo me bon me dyshu shume në këtë punë, po thu qe se ka kalu etazhitetin por kjo nuk qëndron shiko mirë në këtë ortofoton e re ka dal komplet në pronën komunale, pse se kemi pranu na një historiat qesaj prone çka keni bo ju si drejtorat. Keshillë e jemja është ikjuni qëtyne këmbimeve sepse nuk ju vjen era e mirë, ky zoteria ka hy komplet ne pronë komunale edhe nuk ka reagu as drejtoria e inspektionit as urbanizmit edhe ka vazhdu. Tash kjo pronë po na vjen këmbim sepse është interes i tij por ky mas pari e ka uzurpu pronen komunale për me ardh qetu.

Te qeto prona e pava në liste të pronave me një numer L, R thye për diçka këtyne pronave ose ½ tyre ju ka ndrru pronari në 2021 pyetja është a ka ble tokë a ka nda a çka u bo pse bash qekjo

pronë. Pastaj z. Ganiqi theksoi në si levizje vetëvendosje nuk marrim pjesë në votim nuk i legjitimojmë, po ta jap një keshillë si drejtor mos procedo me tutje pa u saqru të gjitha çështjet.

Z. Labinot Panxha : theksoi ti drejtor the që është interes i personit fizik ndërsa ligji e thotë që prona këmbëhet vetëm nëse është interes publik, materiali që na ka ardhë është i manget në kundërshtim me ligjin , neni 24 i ligjit thot për kembim te procedurave të pronës se komunës obligohet kryetari që paraprakisht të këtë raport zyrtar se nuk egzistojn prona të tjera të komuës përshtatshme për këtë qëllim, po ti ceki nenet tjera për realizim të projektit duhet të jenë edhe raportit për mjetet financiare për këtë interes publik nuk e kemi këtë raport, prona e paluhatshme e komuës që jepet në shfrytëzim nuk duhet të këtë kontest gjyqësor se keni dëshmu me dokumentacion, neni 25 Komuna duhet të siguroj vlerësimin e pronës se palujtshme në bazë të legjislacionit në fuqi, pra ky material i gjithi është në kundërshtim me ligjin dhe unë propozoj që mos të procedohet më tutje.

Z. Mentor Bajri: në bazë të asaj që po e shoh unë të dy ortofotot janë të njejta por se është uzurpim ajo po shihet.

Z. Arjanit Krasniqi: hyrja në bodrum është pronë komunale për këtë arsye po bëhet këmbim karshi interesit të përgjithshëm që ka komuna që janë prezentu edhe në listën e pronave. Askush nuk blen pronë pa e pasur qëllimin me legalizu objektin apo shtëpinë që e ka ndertu në pronën komunale ai diqysh duhet me legalizu. Së pari duhet me kalu në kuvend pastaj shkon në vlerësim, vlerësimin e bënë një komision vlerësues nga Ministria e Financave e jo komuna.

Znj.Xhevahire Ceku Kelmendi: theksoi pavarësisht që është qëllimi i mirë për këtë këmbim për shëtitore unë mendoj që është më mirë të zgjerohet rruga në atë pjesë.

Me katër vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim dhe 5 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim i rekomandohet për shqyrtim dhe rekomandim kuvendit propozimi i DÇPJ-së dhe Kryetarit të Komunës për këmbim prone në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit dhe Albert Ajdaj, nga Peja, për rregullim dhe zgjerim të shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” Pejë.

3.2 Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe Kryetarit të Komunës për këmbim të pronave në mes të

Komunës së Pejës dhe pronarit Jakup Krasniqi nga Peja, për rregullimin dhe zgjerimin e hapsirës gjelbëruese të shkollës fillore “7Shtatori” në f.Vitomericë Komuna e Pejës.

Z.Arjanit Krasniqi: theksoi që këtu kemi një pronë e cila ndodhet në oborrin e shkollës 7 shtatori në Vitomericë është pronë e pronarit privat në sipërfaqe prej 2 ari apo 200 metra katror, këta ma herët kanë fillu me ndertu një objekt por ka reagu komuna edhe është rrenu. Prona është brenda vijes ndërtimore të shkollës dhe është shpall pronë me interes publik, këtë pronë e këmbëjmë me

pronën të cilën e ka qe një kohë të gjatë në shrytezim pronari Jakup Krasniqi përball shkolles Ramiz Sadiku në Pejë me sipërfaqe 175 metra katror këtë pjesë ai e ka në shfrytëzim që disa vite. Për komunën është interes publik me i marr këta 2 ari tokë në oborr të shkollës dhe me spastru këtë pjesë të oborrit të shkollës duke e propozu me pronarin në fjalë me këtë pjesë që e ka në shfrytezim.

Z. Berat Ganiqi: prapë kam dyshimet e mia 200 metra katror të shkolla në Vitomericë të këmbehen me 175 metra katror të shkolla "Ramiz Sadiku", kjo nuk është në rregull çfarë vendi aty e kom shtëpinë, është e vertet aty ka uzurpime kaher e ka edhe kontrollen teknike u dashte me cekë. A e din çka po këmbejmë 200 metra katror që ky i ka Vitomericë në shfrytezim për 99 vite e po i jepim një pronë të përhershme te shkolla "Ramiz Sadiku" me 25 metra me pak por çmimi qaty vitomericë mundet me shku ma se shumti deri 7 mijë euro për ari 14 mijë krejt, ndërsa të shkolla "Ramiz Sadiku" shkon dikun trefishë ma shumë, plus 99 vite qirambajtje hajde po ia japim komunës se Pejës çka mbas kësaj periudhe kohore nipat, sternipat tanë thojnë çka ka përfundu tash së komuna në atë kohë e ka jep qeshtu. Mos të shkojmë bre në qesi këmbimeve une po e kuptoj interesin e komunës me dal mirë po duhet me shiku edhe interesin mos me u demtu, mos me demtu Pejën plus mbas ku e ka ky pronën ka me u bo një plan i rregullimit, janë rrezu disa shtëpia njerëzve u është dhënë banesë në rregull o ajo e përkrahi po shikone mirë qatë rregullimin e bashkësis teritoriale Rrokaqelli qe e rregullon edhe atë pjesë ku po mungojnë qeto sene kom dyshime prapë po e them nuk i legjitimoj qetu sene me votë.

Z. Labinot Panxha: edhe kjo mendoj si pika më lartë nuk është në përputhje me ligjin dhe kërkoj që të mos procedohet më tutje pa plotesim të dokumentacionit në përputhje me ligjin.

Z. Arjanit Krasniqi: për çështje e vlerësimit që u përmend 200 metra katror jo 175 metra katror vlerësimi kryhet veç e veç atë punë e bënë komisioni vlerësues i Ministrisë bazuar në çmimet e tregut aktualisht që i marrin mostrat e çmimeve të shitjes në 3 vitet e fundit. Komisioni e bënë vlerësimin veç e veç për səcilen pronë përmes kësaj ne po mundohem ta maksimalizoj vlerën e pronës komunale përmes këtyre këmbimeve. Ne mendojmë që jemi duke e bërë punën me të mirë, kemi me i pru në kuvend të gjitha pronat që i ka prezentu kryetari në listën e pronave.

Z. Labinot Panxha: nuk është këtu puna me nxan dikun keq, qëllimi është që mos me bo politika ditore e me punu në interes të dikuj por me mendu edhe për të ardhmen. Se tani e shohim ai e ka marrë këtë pronë në shfrytëzim për 99 vite tash kanë mbet përafërsisht edhe 68 vite mbas këtyre e merr dikush tjetër në shfrytëzim e këtu po i bie që ka perfitu një person fizik.

Me 5 vota pro dhe 4 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës për këmbim të pronave në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Jakup Krasniqi, nga Peja, për rregullimin dhe zgjerim hapsirës gjelbëruese të shkollës fillore "7Shtatori" në f.Vitomericë Komuna e Pejës.

3.3. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Rahmon (Rexhë) Shala, nga Peja për rregullim e rrugës në Pejë, sipas PRRU.

Z. Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për një pronë private në bazë të ortofotos mund ta shihni është pronë private e pronarti Rrahmon Shala me tersi prej 41 metra katror, propozohet për këmbim me pronën komunale në bazë të Ortofotos po shihet që këto kanë qenë si mur e kanë mbet tani si ishuj njëra parcel është 12 metra ndërsa tjetra 57 metra qe gjithësej janë 69 metra katror na edhe më herët e kemi nda një parcel me ta por ather nuk kanë pas interes edhe për këtë pjesë tjetër, ne e kemi rrenu një objekt që këta e kanë pas buzë Lumbardhit më herët ata qe janë kanë pjesë e kuvendit e kanë pas edhe një herë këtë këmbim përpara. Na i këmbejmë këta ishuj, këtij i rregullohet sipërfaqja ndërtimore, na s'kemi interes as me mbajt peng investitorin edhe për ne ajo pronë nuk është interes me komuna, ndërsa pronen e këtij pronari komuna do ta merr për interes publik për krijimin e një hapësire për parkingje për banoret e lagjes Jarina ku e dim së për çdo ditë kanë ankesë qytetarët. Ndërsa pjesa e pronës komunale ndodhet sipër kishës Katolike ku ne pretendojmë që me bo zgjidhje përmes këmbimit.

Z. Labinot Panxha: se pata të qartë çka po këmbehet, unë po e kuptoj që po bëhet me qëllim të mirë por unë mendoj që ish kanë mirë me obligu këtë pronarin e ndërtesave qe me nda atë pjesë të sipërfaqes për banesa për familjet që janë në social sesa me zgjeru ni rrugë që unë kaloj andej gati çdo ditë dhe nuk o ndonjë interes urgjent. Pra me i nda nja dy a tri banesa për këto familje.

Znj . Myrvete Salihu: me i bo këto banesa e me lanë Jarinen pa parking, unë jom rrit aty edhe a e din sa problemin e kanë banorët e asaj pjesë për parking.

Z. Berat Ganiqi: ky parking qe paska me u bo a do të jetë me pages a pa pages, se jeni ardhë edhe te shkolla "Ramiz Sadiku" e keni bo kishe pa pagesë po sot ai paguhet prej banorëve 0.40 cent e paguj unë. Roli jon o opozit me dhanë këshilla me kritiku ku mendoj që nuk o mirë nuk jemi na pozitë veç me qu e me ule dorën kështu që tendenca për mos me na lanë me fol si këtu si në kuvend nuk o e mirë. Me ja ditë hallin parkingjeve të banorëve si kishin lon ato ndërtimi ashtu e banoret tu mos pas mundësi parkingu po ju vendosen bllokadat nëpër goma kjo so në rregull na kemi me i mbrojt interesat e qytetarëve e jo të kerkujt tjetër. Komuna ta ndal kontraten për kompaninë që po ju vendos bllokaden se kur kanë qenë zgjedhjet asnjë bllokadë në nuk e ki. E kom pasë nënën me kancer ma kanë blloku policia pse e ki parku mbi Jazë, derivat i kontratës që ka lidh komuna.

Znj . Myrvete Salihu: spo ju mohoj të drejten e juaj si opozitë po thjesht u qasa që mos të zgjaten procedurat pa nevojë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: realisht une po kam tolerime për juve por duhet ta respektojmë rrjedhen e punës së komitetit.

Me 5 vota pro dhe 4 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi të DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Rahmon (Rexhë) Shala, nga Peja, për rregullim e rrugës në Pejë, sipas PRRU-së.

3.4. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ-së dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Mediha Hoxha nga Peja, për rregullim e shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU-së

Z. Arianit Krasniqi: ky propozim vjen edhe një herë përpara jush, disa prej jush keni qenë pjesë e kuvendit disa jeni tjerë është një pronë që ne e kemi kry në procedurë, por ata në vlerësim nuk na kanë pranuar sepse këta pronarët i kanë bo disa ndamje të parcelave dhe kanë marrë tjetër numër edhe pse ti ja dëshmon me sipërfaqe me aktëvendim kur është bo ajo rrjedhimisht ajo ndarje e ka pasë numrin sipërfaqja 5915/ 1, e ka marrë numrin kur është nda ka marrë 5915 /5 sipërfaqja është 120 metra katror ndërsa pjesa tjetër e parcelës 5915/2 e ka marrë një numër tjetër 5915/7 me sipërfaqe prej 12 metrave katror siç e keni pa edhe materialin andaj tani vlerësimi do të bëhet për këto parcela. Na kur e kemi dërgu në kuvend e kemi pas bo edhe këmbimin e këtyre dy parcelave. Më tutje në mënyrë të detajuar drejtori e shpjegoj procedurën e këmbimit para anëtarëve të komitetit.

Z . Pandeli Rugova: propozoj që të shfuqizohet vendimi paraprak dhe të merret vendim i ri në mënyrë që komisioni ta ketë më të lehtë vlerësimin.

Me 5 vota pro dhe 4 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ-ës dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për këmbim pronash në mes të Komunës së Pejës dhe pronarit Mediha Hoxha, nga Peja, për rregullim shtegut të ecjes buzë Lumbardhit sipas PRRU.

3.5. Shqyrtimi i kërkesës së “Let’s Do It Peja”, për angazhimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal Pejë, në Grupin punues për hartimin e “Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit” në

Komunën e Pejës

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: e keni marrë si material paraprakisht fjala është për zgjedhjen e dy anëtarëve nga kuvendi.

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: cila parti i propozon sepse këtu po thotë që duhet të njohin fushën.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit kërkesa e “Let’s do it Peja”, për angazhimin e anëtarëve të kuvendit komunal Pejë në grupin punues për hartimin e planit lokal të veprimtimit për cilësinë e ajrit në komunën e Pejës.

3.6. Rritja dhe bartja Buxhetore e mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake.

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marrë me vonesë, drejtori na ka lajmëru që nuk mundet me qenë sot ne takim mbetë që për sqarime më shumë të diskutohet në kuvend.

Z. Berat Ganiqi: shpresoj që mo nuk na vjen me vonesë materiali sepse na kemi drejtë edhe mos me shti rend dite.

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: sipas drejtorit vonesa ka qenë si shkak i mosbarazimit me thesar.

Z. Labinot Panxha: pyetja ime shkon se kjo vlera për paga dhe meditare 23,807.00 euro për ku do të destinohen këto.

Znj. Xhevahire Ceku Kelmendi: nëse këto paguhen për orë shtesë për inspektora atëherë duhet me ju pagu edhe inxhinierave a e dinë sa punën e bojnë ata jashtë orarit.

Me 5 vota pro, 3 kundër dhe një i përmbajtur i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratimi, rritja dhe bartja Buxhetore e mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake.

3.7. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe Plani për ndarjen e tyre për vitin 2022.

Znj. Hidajete Nikqi: këtu po e shoh që vitin e kalum subvencionet për bursa kanë qenë 3000 euro ndërsa për këtë vit 30000 euro po me intereson mos o ndonjë gabim teknik apo është e vërtetë. Dhe ndërtimi i shkollave dhe ankesave s'po e shoh që ka mjete për materialin shpenzues sidomos shkollat profesionale.

Znj. Xhevahire Ceku Kelmendi: subvencione dhe shoqatat tjera këtu deshta me u lidh a ka me nda diçka komuna për organizatën e veteranëve të luftës mu me ka ardh kërkesë prej kryetares Safetës dhe unë i kom premtu që do ta ngris këtë qështje. Kish qenë mirë me subvencionu që së paku ta ketë një pagë ajo vajza që rrin aty. Edhe subvencione sipas kërkesave është e paqartë.

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: herën e kalume bursat janë nda veç për drejtimin e matematikës, kësaj radhe a kanë me u nda edhe për drejtime tjera se na kemi kerku mandatin e kalum me u nda bursa edhe për drejtime tjera.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informata mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe Plani për ndarjen e tyre për vitin 2022.

4. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: a ka mundësi inspektoriati me dalë në terren për me i inspektu këto marketet e mëdhaja e jo me i ngritë çmimet brenda ditës ashtu qysh ata po dojnë.

Znj. Xhevahire Ceku Kelmendi: jo vetëm marketet por të inspektohen edhe depot ndërtimore, të shikohet dokumentacioni i pranimit të mallit e mos të lejohen keqpërdorime.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk pati, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:00 h.

Procesmbajtësi,

z. Avni Gashi

